



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 50 Datë 29-05-2025

**PËR MIRATIMIN E KONTRIBUTIT FINANCIAR TË BASHKISË KORÇË PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSIONI I PALLATIT TË SPORTIT
“TAMARA NIKOLLA”, SHITESË KATI (PUNIME FASADE) ME CIKËL FINANCIMI
2025-2026**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin 115/2024 datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, udhëzimin plotësues nr.2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, urdhërin nr.12 datë 14.01.2025 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2025 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë sipas programeve dhe produkteve”, i ndryshuar, si dhe në urdhërin nr. nr. 60 datë 7.02.2025 “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve nga programet “arsimi bazë”, “arsimi i mesëm” dhe programi “për sportin”, pjesë e programit për infrastrukturën shkollore e sportive, për projektet me cikël financimi 2025-2026”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë kontributin financiar të Bashkisë Korçë për financimin e projektit Rikonstruksioni i Pallatit të Sportit “Tamara Nikolla”, shtesë Kati (punime fasade), Korçë”, me cikël financimi 2025-2026 sipas tabelës së mëposhtme:

/lekë

Nr.	Emërtimi i projekteve	Vlera e totale e projektit	Kontributi 20% Bashkia	Angazhimi 10% 2025	Angazhimi 10% 2026	Kontributi 80% MAS	Angazhimi 2025	Angazhimi 2026
1	Rikonstruksion I Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla", shtesë kati (Punime fasade)	35,891,220	7,178,244	7,178,244		28,712,976	5,742,595	22,970,381
2	Mbikqyrje e objektit Rikonstruksion I Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla", shtesë kati (Punime fasade)			544,404				
3	Rikonstruksion I Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla", shtesë kati (Punime fasade)			65,328				
	Total	35,891,220	7,178,244	7,787,976	-	28,712,976	5,742,595	22,970,381

2. Angazhimin buxhetor i Bashkisë është 7,787,976 lekë, do të përballohet nga fondi i planifikuar për objektin "Investime në shkollat e arsimit bazë parashkollor", në programin arsimit bazë parashkollor AG122, me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET Prog. AG122 Prod. P912AAA 00 09120 05 Art. 2310000 -7,787,976 lekë (Bashkia)

SHTOHET Prog. AF122 Prod. P813AAY 00 08130 05 Art. 2310000 +7,787,976 lekë (Bashkia)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, si dhe Drejtoria e Prokurimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratur me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Pro

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-05-2025

